

Shoqëria e Sigurimit



Raporti
Vjetor

Misioni dhe vizioni	5
Profili i shoqërisë	6
Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm	7
Veprimtaria në sigurimin jo-jetë të shoqërisë	8
1. Përmbledhje ekzekutive	
1.1. Veprimtaria e ALBSIG JETË Sh.a	9
1.2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2025	9
2. Kuadri i Administrimit të Riskut	
2.1. Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut	11
2.2. Kuadri i raportimit	12
2.3. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve	12
3. Përmbushja e strategjisë së menaxhimit të riskut	
3.1. Rezultatet e marrjes në sigurim për vitin 2025	18
3.2. Toleranca dhe kufijtë e riskut	19
3.3. Kufijtë për risigurim	19
3.4. Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Pagueuse	19
3.5. Aktive në mbulim të provigjoneve teknike	20
3.6. Mjaftueshmëria e kapitalit	21
4. Skenarët e stress-testeve	
4.1. Vetëvlerësimi i riskut, ORSA	22
4.2. Teste të paralajmërimit të hershëm	23
5. Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe Përballimit të situatave të paparashikuara	
5. Planet e vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara	24
6. Raporti i audituesit të pavarur	
6.1. Opinioni i Auditorit të Jashtëm	25
6.2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar	28
6.3. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse	29
6.4. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	30
6.5. Pasqyra individuale e flukseve monetare	31
6.6. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale	32
7. Auditimi i brendshëm	
7.1. Objektivi dhe qëllimi i Auditimit të Brendshëm	36
7.2. Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm	36
7.3. Pohimi për pavarësinë	36
7.4. Struktura organizative dhe raportimi	36
7.5. Opinioni i Audituesit të Brendshëm	36

8. Përgjegjësia Sociale e Albsig Jetë sha.

8.1. Pjesëmarrja në "FSHN-UT Open Day"	37
8.2. Albsig, një mundësi për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2025.....	37
8.3. Albsig në Panairin e Karrierës të Western Balkans University	38
8.4. ALBSIG organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.....	38
8.5. ALBSIG për Tetorin Rozë. Kujdes, ndërgjegjësime dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes	39

9. Veprimtaria e Albsig për vitin 2025

9.1. Pashka në Albsig Harmoni, traditë dhe momente të paharruara.....	41
9.2. Një ditë e dedikuar argëtimit, bashkëpunimit dhe frymës së ekipit.....	41
9.3. Nga siguria te investimi: Albsig mirëpret median në ambientet moderne të Downtown One	42
9.4. ALBSIG FESTON 21-VJETORIN! 21 vite besim, rritje dhe lidhësi në tregun e sigurimeve	43
9.5. Trajnim për Inteligjencën Artificiale: Albsig forcon kapacitetet e stafit drejt inovacionit teknologjik.....	45

10. Objektivat strategjike dhe vjetore

10.1. Objektivat strategjike dhe vjetore	46
--	----

⌘ ALBSIG *Jeté*



MISIONI DHE VIZIONI

MISIONI

Albsig — Jetë është shoqëri sigurimi jete e orientuar nga cilësia, rritja e gamës së produkteve dhe portofolit, ruajtja e një gjendje financiare të shëndoshë, dhe e dedikuar të përmbushë sa më mirë kërkesat e konsumatoreve për produkte të sigurimit të jetës në tregjet dhe segmentet ku operon..



VIZIONI

Vizioni i aksionerit të shoqërisë është pozicionimi i shoqërisë si një nga shoqëritë kryesore të sigurimit të jetës në vend, e cila ofron një gamë të gjerë produkteve tradicionale dhe novatore të sigurimeve të jetës.





PROFILI I SHOQËRISË

→	Emri i Shoqërisë:	ALBSIG Jetë sh.a.
→	Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:	Plarent Hamzaj - Anëtar Redi Ujkashi - Anëtar Klodian Gjonaj - Anëtar
→	Drejtor i Përgjithshëm:	Z. Ervin SPAHIU
→	Lokalizimi i zyrave qendrore:	Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16, 1010 - Tiranë
→	Data e themelimit:	02 / 07 / 2019
→	Kapitali themeltar:	432,254,000 lekë
→	Numri i punonjësve:	12
→	Aktiviteti:	Në veprimtarinë e siguruesit të (Jetës)
→	Tel:	+355 42254664
→	Website:	www.albsig-jete.al
→	Kontakt:	info@albsig-jete.al



Të nderuar klientë dhe bashkëpunëtorë!

Me kënaqësi dhe krenari të vecantë, ju paraqes raportin vjetor të Albsig Jetë për vitin 2025.

Ky vit ka qenë një periudhë tepër e rëndësishme për ne, plot sfida dhe arritje që kanë ndihmuar në përparimin e shoqërisë dhe në përmbushjen e angazhimeve tona ndaj të gjithë palëve të interesit.

Viti 2025 shënoi një hap të madh përpara në adoptimin e teknologjive të reja dhe inovative. Ne kemi investuar në zhvillimin e platformave digjitale që të mund të lehtësojnë procesin e sigurimit për klientët tanë, duke ofruar një përvojë të përmirësuar dhe më të shpejtë. Ne jemi të përkushtuar të ofrojmë një shërbim të shkëlqyer ndaj klientëve tanë.

Gjatë vitit 2025 kemi rritur ndjeshëm standardet tona të shërbimit duke ofruar më shumë transparencë, fleksibilitet dhe mbështetje. Këto përmirësime kanë ndihmuar në rritjen e kënaqësisë së klientëve dhe në ndërtimin e një marrëdhënie më të fortë dhe të qëndrueshme me ta. Gjatë vitit 2025 është investuar në trajnimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve tanë. Kemi krijuar programe të reja për zhvillimin e lidershit dhe për rritjen e aftësive të punonjësve tanë, duke siguruar që ata të jenë të përgatitur për të përballuar sfidat e së ardhmes dhe për të kontribuar në rritjen e shoqërisë. Ajo që duhet të theksojmë më së shumti është përgjegjësia sociale dhe qëndrueshmëria të cilat janë pjesë thelbësore e strategjisë së korporatës tonë. Ne kemi vazhduar të mbështesim e të promovojmë mirëqenien e komuniteteve. Gjatë vitit 2025 kemi realizuar disa iniciativa të rëndësishme, duke përfshirë programe edukimi financiarë.

Në përfundim dua të shpreh mirënjohjen time të thellë për gjithë ekipin e Albsig Jetë sh.a., që me përkushtim dhe punë të palodhur kanë bërë të mundur këto arritje. Ne jemi të përkushtuar të vazhdojmë në këtë rrugë suksesi dhe të realizojmë objektivat tona për të ardhmen.

Me respekt dhe mirënjohje,
Ervin Spahiu

Klasat e sigurimeve të Albsig Jetë sh.a.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig Jetë sh.a. e regjistruar në QKB me NIPT L92019070V, në mbështetje të Vendimit të Bordit të AMF-se nr. 171, date 13.09.2019, do të ushtrojë veprimtari sigurimi jetë në këto klasa sigurimi:

→ Klasa 19. Sigurimi i jetës

- 19.1 Sigurimin për vdekjen;
- 19.2 Sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;
- 19.3 Sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;
- 19.4 Sigurimin e jetës me kthim të primeve.

→ Klasa 20. Sigurimi martesë – lindje

- 20.1 Shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;
- 20.2 Përfundimi i kushteve të sigurimit, i cili ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.

→ Klasa 21. Sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive mbulon:

- 21.1 Sigurimin e jetës, në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.

→ Klasa 22. Anuitetet

- 22.1 Sigurim jete me elemente kursimi;
- 22.2 Sigurim jete me afat të përcaktuar;
- 22.3 Anuitete të shtyra;
- 22.4 Anuitete të menjëhershme.

→ Klasa 23. Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

- a. Vdekje si rezultat i aksidentit;
- b. Paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;
- c. Paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;
- d. Paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
- e. Paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;
- f. Paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;
- g. Shërbimet spitalore;
- h. Sëmundjet e pashërueshme;
- i. Shërbimet mjekësore.

1.1. Veprimtaria e ALBSIG JETË Sh.a

Albsig Jetë sh.a. (tani e tutje do i referohemi si "Shoqëria") është themeluar më 2 korrik 2019 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Rruga e Barrikadave, (Pallatet 9 Katëshe) Nr.1001. Shoqëria është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 19 korrik 2019 me numër identifikimi L92019017V.

Kapitali i Shoqërisë është 432,254 mijë Lek i ndarë në 432,254 aksione me vlerë nominale 1.000 Lek/ aksion e zotëruar 100% nga Albsig sh.a..

31 dhjetor 2025			
	në %	Numri i aksioneve	Në lekë
Albsig Jetë sh.a	100%	432,254	432,254,000
Totali	100%	432,254	432,254,000

1.2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, aktiviteti i shoqërisë Albsig Jetë sh.a. paraqitet pozitiv, i shoqëruar me rezultat financiar fitimprurës dhe me zhvillim të qëndrueshëm të veprimtarisë. Performanca ekonomiko-financiare e vitit 2025 kontribuoi në pozicionimin e Albsig Jetë sh.a. në vendin e parë në tregun e sigurimeve të jetës në Shqipëri, duke e konfirmuar atë si shoqërinë më të madhe në treg. Në të njëjtën kohë, shoqëria ka vijuar të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me standardet profesionale, kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi, duke konsoliduar më tej pozicionin e saj institucional dhe financiar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 2,435,255 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 17.62% krahasuar me vitin 2024. Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 185,833 duke shënuar një rritje në masën 21.67% krahasuar me vitin 2024.

Primet e Shkruara Bruto dhe Dëmet e Paguara nga Shoqëritë e Sigurimit të Jetë							
Gross Written Premiums and Paid Claims by Life Insurance Companies							
					Ndryshimi	Pjesa ndaj Totalit	
Shoqëria e sigurimit		(Vlera në mijë lekë)			(në %)	(në %)	
Insurance Company		Value (in thous.ALL)			Change	Share in total value	
					(in %)	(in %)	
Viti/Year		2024		2025	25/'24-1	2024	2025
Primi i Shkruar Bruto / Gross Written Premiums							
Albsig jeta		500,056		939,002	87.78	24.15	38.56
Sigal Life Insurance Group		820,456		744,427	(9.27)	39.63	30.57
Sicred		334,755		376,511	12.47	16.17	15.46
Insig jeta		415,156		362,965	(12.57)	20.05	14.90
"Viena Life Insurance" Viena Sigurim Jete		—		12,351	—	—	0.51
TOTAL		2,070,422		2,435,255	17.62	100.00	100.00

Shoqëria e sigurimit	Nr	(Vlera në mijë lekë)	Nr	(Vlera në mijë lekë)	Ndryshim i vlerës (në%)	Pjesa ndaj Totalit(në %)	
Insurance Company	Number	Value (in thous.ALL)	Number	Value (in thous. ALL)	Change in value (in %)	Share in total value(in %)	
Viti/Year		2024		2025	25/'24-1	2024	2025
Dëme të paguara Bruto dhe Numri i Dëmeve / Gross Claims Paid and Number of Claims Paid							
Sigal Life Insurance Group	226	178,099	181	133,915	(24.81)	53.30	41.84
Insig jeta	1,355	57,149	1,143	81,376	42.39	17.10	25.42
Sicred	1,410	62,376	1,788	63,068	1.11	18.67	19.70
Albsig jeta	485	36,542	312	41,085	12.43	10.94	12.84
"Viena Life Insurance" Viena Sigurim Jete	—	—	33	627	—	—	0.20
TOTAL	3,476	334,167	3,457	320,070	(4.22)	100.0	100.00

- ➡ Gjatë vitit 2025, që është viti i gjashtë i plotë i aktivitetit, shoqëria Albsig Jetë Sh.a. është pozicionuar në vend të parë në tregun e sigurimeve të jetës duke zënë 38.56 % të tregut.
- ➡ Shoqëria Albsig Jetë Sh.a. për vitin 2025 arriti dhe tejkaloi objektivat e saj, duke rritur dhe konsoliduar më tej prezencën e saj në tregun e sigurimeve të jetës , me një rritje prej 87.78 % të volumit të shitjeve dhe me një zgjerim të prezencës nga 24.15% në 38.56% të tregut.
- ➡ Shoqëria Albsig Jetë Sh.a. gjatë vitit 2025 është pozicionuar në vend të parë në tregun e sigurimeve të jetës në produktin e Jetës së Debitorit duke zënë 46.66 % të tregut nga 26.71% për vitin 2024 dhe duke patur rritje me 101.53 %.
- ➡ Për vitin 2025 shoqëria Albsig Jetë sh.a. ka paguar 312 dëme me vlerë 41,085 mijë lekë ndërkohë që për vitin 2024 janë paguar 485 dëme me vlerë 36,542 mijë lekë.

Shoqëria Albsig Jetë Sh.a. mbikëqyrret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore.

Albsig Jetë Sh.a., ka vendosur objektiva të qarta për periudhën 1-vjecare dhe 3-vjecare ku rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo kërkon vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të riskut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj risqeve me të cilat përballet shoqëria. Këtu merr kuptim Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e risqeve, por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut. Çdo njësi e qeverisjes duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të paktën një herë në vit) si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

2.1 Menaxhimi i riskut, strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut

Sistemi i menaxhimit të riskut:

- Përbëhet nga strategji, procese dhe procedura raportimi të nevojshme për të identifikuar, matur, menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme risqet, në një individ dhe në një nivel të agreguar, të cilat janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe ndërvlerësitë e tyre.

Ky raport përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në shoqërinë Albsig Jetë sh.a., metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e shoqërisë Albsig Jetë me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.



Shoqëria Albsig Jetë sh.a. në muajin Dhjetor 2025 në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës miratoi projektplanin 3 vjecar për vitet 2026 – 2028. Ky plan ndihmon në ecurinë e shoqërisë dhe në ndërtimet e standarteve për shoqërinë Albsig Jetë sh.a.. Në planin e Biznesit 3 vjecar 2026 –2028 u përcaktua dhe ambicja e shoqërisë Albsig sh.a., për arritjet e pritshme për tu realizuar për vitin 2026, 2027 dhe 2028.

Plani i menaxhimit të riskut për vitin 2025 përfshin objektivat përkatëse, parimet kryesore dhe shpërndarjen e duhur të përgjegjësiave për të trajtuar riskun në të gjithë veprimtarinë dhe njësitë organizative të shoqërisë së sigurimit Albsig Jetë sh.a.. U përcaktua niveli i pranueshëm i riskut, i përcaktuar qartë dhe i miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes, duke u këshilluar me drejtuesit e lartë ekzekutivë..

KU përcaktuan objektivat që duhet të zbatohen dhe ndiqen nga gjithë njësitë përbërëse të shoqërisë Albsig Jetë sh.a. Këto objektiva janë të vendosura në planin ekonomik financiar si më poshtë:

- Synimi për të konsoliduar pozicionin e shoqërisë si lider në tregun e sigurimeve të jetës, me fokus të veçantë në cilësinë e shërbimit ndaj klientëve.
- Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe në kohë për klientët individë dhe bizneset, nëpërmjet produkteve ekzistuese dhe zhvillimit të produkteve të reja të sigurimit.
- Përmirësimi i mëtejshëm i procesit të administrimit dhe pagesës së dëmeve, me synim trajtimin e shpejtë, korrekt dhe transparent të kërkesave për dëmshpërblim.
- Ruajtja e standardeve të larta në përzgjedhjen, kualifikimin dhe zhvillimin profesional të personelit të përfshirë në marrjen në sigurim, shitje dhe ndërmjetësim në sigurime.
- Zhvillimi dhe hedhja në treg e produkteve dhe shërbimeve të reja për tregun shqiptar të sigurimeve të jetës, në përputhje me praktikat më të mira europiane dhe në bashkëpunim me partnerët risigurues.
- Forcimi i kuadrit të administrimit të risqeve dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve të kontrollit të brendshëm.
- Ruajtja e një raporti të aftësisë paguese në nivel jo më të ulët se 250% ndaj nivelit minimal të kërkuar, me qëllim krijimin e kapaciteteve absorbuese ndaj luhatjeve të mundshme të rezultateve financiare.
- Synimi për mbajtjen e një niveli minimal të kthimit mbi kapitalin, ROE, prej 10%, të llogaritur mbi kapitalin e vlerësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- Ruajtja dhe konsolidimi i volumit të primeve të shkruara bruto në raport me vitin 2025.
- Pagesa shumë e shpejtë e dëmeve.
- Konsolidimi i mëtejshëm i pozicionit të Albsig Jetë sh.a. si shoqëria më e madhe në tregun e sigurimeve të jetës në Shqipëri.



2.2 Kuadri i raportimit

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut dhe kontrollit, duhet të marrë masat e duhura sipas nevojës. Ka një numër të mënyrave të cilat mund të përgjigjen ndaj riskut, duke përfshirë:

- Transferimi i një pjese të riskut; për shembull, duke blerë sigurim ose risigurim;
- Trajtimin ose zbutje të riskut; dmth të zvogëlojë gjasat dhe/ose ndikimit të tij;
- Të pranojë ose të tolerojë nivelin aktual të riskut, ku risku i afrohet apo është në kufijtë e tolerancës së riskut. Kjo mund të jetë e përshtatshme ku zbutja e nivelit aktual të riskut është në disproporcion me përfitimet.
- Eliminimin ose përfundimin..

Në programin e administrimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria. Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjikë. Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut për periudhën. Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme. Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuara më poshtë.

2.3 Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm. Në Planin e menaxhimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballet shoqëria.

Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjikë. Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme.

Risqet Kryesore

- Risku i sigurimit
- Risku i kreditit
- Risku i tregut
- Risku i likuiditetit
- Risku operacional
- Risku ligjor
- Risku strategjik

Risqet të tjera

- Risku i këmbimit të monedhës
- Risku reputacional



➤ Risku i Sigurimit

Kontratat e sigurimit të jetës që lidh shoqëria Albsig Jetë sh.a. përfshijnë pranimin e një rreziku domethënës nga policë-mbajtësi, ku shoqëria merr përsipër të kompensojë dëmin në rast të një ngjarjeje të paparashikuar dhe të mbuluar nga kontrata (ngjarja siguruese). Rreziku lidhet me mundësinë e ndodhjes së ngjarjes dhe pasigurinë mbi shumën e dëmit. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve. Këto rreziqe ndahen në:

- Rreziqe afatshkurtra (që ndikojnë menjëherë në performancën e portofolit), dhe
- Rreziqe afatgjata (që ndikojnë në qëndrueshmërinë e portofolit në kohë).

Procesi i Marrjes në Sigurim

Marrja në sigurim realizohet nga Departamenti i Marrjes në Sigurim dhe Marketingut dhe përfshin disa njësi të cilat janë përgjegjëse për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut mjekësor dhe jo-mjekësor, përfshirë:

- Rrezikun e profesionit
- Rrezikun e rezidencës
- Rrezikun nga aktivitetet e kohës së lirë
- Rrezikun financiar
- Rreziqe të tjera.

Etapat e Marrjes në Sigurim

a) Identifikimi i Rrezikut

Bazohet në mbledhjen e informacionit për:

- Gjendjen shëndetësore (nëpërmjet deklaratave, pyetësorëve, raporteve dhe ekzaminimeve mjekësore)
- Profesionin, aktivitetet, vendbanimin, udhëtimet
- Aftësinë për të përballuar primin (nëpërmjet pyetësorëve dhe informacioneve financiare)
- Dokumentacionin e nevojshëm nga institucioni kredidhënës (për sigurimet për hua)

b) Analiza e Rrezikut

Qëllimi është të sigurohet që rreziku i pranuar është brenda kufijve të tolerancës së shoqërisë:

- Rreziku mjekësor vlerësohet vetëm nga mjekë të punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë
- Rreziqet jo-mjekësore (financiare, profesioni, aktivitetet, etj.) vlerësohen nga marrësit në sigurim bazuar në manuale të brendshme dhe tarifa të miratuara

c) Vlerësimi dhe Trajtimi i Rrezikut

- Manuali Life Guide ndihmon stafin për vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e primit
- Në raste të veçanta ose për shumë të larta sigurimi, kërkohet edhe opinion nga risiguruesi
- Stafi është trajnuar sipas standardeve ndërkombëtare të mbështetura nga partnerët risigurues dhe politikave të brendshme të shoqërisë.

Metodologjia për Kontratat në Grup

Për produktet kolektive (jetë, aksidente, shëndet):

- Vlerësimi bazohet në udhëzimet e brendshme dhe kapacitetin e mbajtjes së shoqërisë
- Merret në konsideratë asistencë e risiguruesve dhe brokerëve ndërkombëtarë
- Vlerësohen trendet e dëmeve, historiku i portofolit dhe analiza periodike

Për disa produkte me rrezik të ulët ose shuma të vogla sigurimi:

- Nuk kryhet vlerësim individual i rrezikut
- Primi përcaktohet sipas tarifave fikse dhe limiteve të miratuara



Karakteristikat e Produkteve për vitin 2025

- Të gjitha produktet përfshinin mbulime për vdekjen natyrore dhe disa produkte përfshinin mbulime të veçanta për;
- Paaftësi të përkohshme ose të përhershme
- Shpenzime mjekësore dhe spitalore
- Sëmundje kritike
- etj

Produktet e ofruara nuk përfshinin komponent kursimi apo vlera të kthyeshme.

➤ **Risku i Kreditit**

Risku i kreditit i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primit fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedurë të brendshme nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe risku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj riskut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave.

➤ **Risku i Tregut**

Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

➤ **Risku i normës së interesit**

Risku i normave të interesit është i ndikuar nga risku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe risku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut. Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe risku i shkakut të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

➤ Risku nga kurset e këmbimit

Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEKË, USD dhe EURO). Flukset monetare nga të ardhurat nga primet janë burimi kryesor i fondeve për depozitat me afat në valutë të huaj. Risku i këmbimit të monedhës së huaj lind nga lëvizjet në kurset e këmbimit të monedhës së huaj. Ekspozimi ndaj këtij risku kryesisht lind gjatë një periudhe në të cilën shoqëria ka një pozicion të hapur si në bilanc dhe jashtë bilancit dhe/ose me kursin aktual ose të ardhshëm të tregut. Shoqëria ka qenë dhe mbetet e vëmendshme ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit me qëllim minimizimin e efekteve negative të mundshme financiare si edhe adresimit të çdo problematike brenda kuadrit rregullator.

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 dhjetor 2025 dhe 2024:

Ndikimi		2025 në Lek	2024 në Lek
EUR rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	47,135,338	13,176,084
EUR ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(47,135,338)	(13,176,084)
USD rritet me 10% ndaj Lekut	Fitim	13,176,084	499,048
USD ulet me 10% ndaj Lekut	Humbje	(13,176,084)	(499,048)

➤ Risku Operacional

Rreziku operacional buron nga problematika në funksionimin e proceseve të brendshme të shoqërisë, përfshirë dështime në sistemet dhe kontrollet e brendshme, gabimet njerëzore, keqfunksionime teknologjike, veprimtari të pandershme, si dhe ngjarje të jashtëzakonshme si katastrofat natyrore. Gjatë vitit 2025, Shoqëria Albsig Jetë sh.a. ka vijuar të zbatojë politika dhe procedura për minimizimin dhe menaxhimin e rrezikut operacional në të gjitha hallkat e saj funksionale. Përdorimi më efikas i sistemeve të shitjes, administrimit, financës dhe dëmeve ka ndikuar ndjeshëm në reduktimin e këtij rreziku, duke përmirësuar ndjeshëm bashkërendimin mes funksioneve të kontrollit dhe raportimit. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar procesit të pagesës së dëmeve, duke e konsideruar si një element kyç të reputacionit dhe marketingut të shoqërisë.

Praktika e pagesës së dëmit brenda një afati të shkurtër kohor, e cila përfshin dhe komunikimin proaktiv me klientin për konfirmimin e transferimit të shumës në llogarinë e tij, ka ndikuar pozitivisht në perceptimin e publikut dhe në performancën e shoqërisë. Gjithashtu, analizat aktuariale luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e saktësisë dhe përshtatshmërisë së metodologjisë për përlogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR), me fokus të veçantë në portofolin e sigurimit të jetës së debitorëve. Kontrolli dhe mbikëqyrja mbi cilësinë e të dhënave nga Aktuari janë forcuar, duke kontribuar në rritjen e integritetit të raportimit financiar. Shoqëria ka ngritur struktura dhe politika të mjaftueshme për menaxhimin efektiv të rrezikut operacional. Njësia e Auditimit të Brendshëm raporton rregullisht pranë Këshillit Mbikëqyrës, duke vlerësuar efektivitetin e masave të marra dhe duke identifikuar fushat për përmirësim të mëtejshëm.

Menaxhimi i katastrofave

Shoqëria Albsig Jetë sh.a. ka vendosur një plan të detajuar për menaxhimin e katastrofave dhe rikthimin në gjendje normale pas tyre, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së funksioneve jetike të biznesit. Ky plan përfshin:

Klasifikimin dhe kategorizimin e:

- a) Sistemeve informatike,
- b) Të dhënave informatike,
 - Plani konkret i veprimeve që duhen ndërmarrë në raste emergjente,
 - Caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e masave,
 - Bashkëpunimin me shërbimet publike përgjegjëse,
 - Identifikimin e vendndodhjeve rezervë për operacionet e nevojshme,

- Planifikimin e situatave të adaptueshmërisë gjatë periudhave pas ngjarjeve katastrofike,
- Realizimin e testeve të procesit të menaxhimit të katastrofave,
- Trajnimin dhe informimin e vazhdueshëm të gjithë stafit të Albsig Jetë sh.a.

Të gjitha kontaktet e nevojshme për koordinim dhe komunikim emergjent (numra telefoni, email, adresa) përditësohen rregullisht. Ambientet e shoqërisë janë të pajisura me sisteme fikse zjarri, të cilat mirëmbahen periodikisht dhe përdorimi i tyre është pjesë e trajnimeve të personelit. Për më tepër, të gjitha ambientet e Albsig Jetë sh.a. plotësojnë standardet ligjore për Mbrojtjen Kundra Zjarrit (MKZ), sipas Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” të Republikës së Shqipërisë

Siguria e sistemeve kompjuterike

Shoqëria ka krijuar dhe mirëmban një ambient të veçantë Disaster Recovery, i cili siguron hapësirat dhe kapacitetet e nevojshme për vijueshmërinë e funksioneve kryesore gjatë periudhave kur zyrat qendrore nuk janë të disponueshme. Ky ambient përmban pajisje IT të izoluar fizikisht, të dedikuara për ruajtjen dhe operimin e sistemeve kritike, duke garantuar mbrojtje dhe vazhdimësi të shërbimeve informatike.



Risku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti.

Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një).

Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit dhe është më i lartë se 1 (një).



Risku Ligjor dhe Rregullator

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar format ligjore të organizimit tregtar. Albsig Jetë sh.a. funksionon si shoqëri aksionare me një sistem organizimi dy-nivelesh:

- **Këshillin Mbikëqyrës**, si organi më i lartë ekzekutiv mbikëqyrës,
- **Asamblenë Aksionare**.

Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të Drejtorit të Përgjithshëm, si menaxheri më i lartë i nivelit ekzekutiv, përcaktohen qartë nga Statuti i shoqërisë. Po ashtu, Statuti përcakton edhe kriteret për auditimin e pavarur të pasqyrave financiare nga audituesit e jashtëm, si dhe rregullat për pavarësinë dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Kompetencat dhe funksionet kryesore të organeve drejtuese janë të përcaktuara me qartësi në Statut, i cili përbën bazën ligjore dhe rregullatore për vlerësimin dhe kontrollin e aktivitetit të shoqërisë. Ky sistem organizimi është plotësuar dhe përputhet me kërkesat e ligjit të posaçëm për llojin e aktivitetit që ushtron shoqëria, i cili parandalon konfliktet me aktivitete të tjera tregtare.

Zhvillimi dhe shpërndarja e politikës së pajtueshmërisë ligjore

Shoqëria Albsig Jetë sh.a. trajton në mënyrë rigoroze përputhshmërinë ligjore të veprimtarive të saj, duke siguruar që çdo ndryshim ligjor apo kërkesë zhvillimi të pasqyrohet me përditësime të nevojshme në aktet normative dhe statut. Kjo bëhet në përputhje me kontratën e delegimit të funksioneve ligjore, duke respektuar hierarkinë e miratimit brenda shoqërisë: nga Drejtori i Përgjithshëm, Këshilli Mbikëqyrës, deri tek Asambleja e Aksionarëve, dhe më pas, kur kërkohet, në organet administrative përkatëse.

Rishikimi i politikave ligjore bëhet rregullisht, duke u bazuar në ndryshimet ligjore, kërkesat operative, si dhe gjetjet nga monitorimet e brendshme, për të garantuar që shoqëria operon në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Kontrolli ligjor i aktivitetit të shoqërisë sigurohet përmes një sistemi të mirëorganizuar që monitoron dokumentacionin, transaksionet dhe veprimtaritë, duke siguruar që gjithçka të jetë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. Shoqëria ka zhvilluar rregulla të brendshme dhe korniza organizative të qarta, të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të rishikuara periodikisht, për të garantuar funksionimin e pavarur dhe efikas të strukturës organizative, duke përfshirë manuale të detajuara për përgjegjësitë dhe kufijtë normative të stafit. Në fushën e punësimit, Albsig Jetë ka krijuar një program specifik për rekrutimin dhe vlerësimin e stafit, në përputhje me politikën ligjore dhe standardet për pajtueshmëri, duke siguruar aftësitë e nevojshme për përmbushjen e detyrave.

Kontrolli ligjor i produkteve të sigurimit përfshin miratimin dhe publikimin e produkteve të reja, si dhe verifikimin e zbatimit të procedurave për informimin e klientit dhe identifikimin e tij, në përputhje me rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Trajtimi i dëmeve dhe Kontrolli i procedurave për trajtimin e dëmeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit është i strukturuar dhe monitorohet në mënyrë sistematike, me qëllim të garantimit të një procesi të drejtë, objektiv dhe të zhvilluar brenda afateve të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi. Trajtimi i kërkesave për dëmshpërblim realizohet nga Njësia i Trajtimit të Dëmeve në shoqëri, në përputhje me procedurat e miratuara në "Rregulloren për trajtimin e dëmeve në shoqërinë Albsig Jetë".

Administrimi i riskut referuar auditimit të brendshëm - Shoqëria Albsig Jetë sh.a. ka ngritur Komitetin e Auditimit dhe ka miratuar rregulloren për funksionimin e tij, duke përcaktuar përbërjen, objektivat, përgjegjësitë dhe mënyrën e raportimit. Komiteti ka vepruar në mënyrë të pavarur, në përputhje me Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Sipas Planit të Auditimit të Brendshëm dhe Metodologjisë së Raportimit, gjatë periudhës janë kryer:

- Kontrollat parandaluese, zbuluese dhe korrigjuese mbi informacionin financiar dhe veprimtarinë;
- Kontrole tematike për menaxhimin më të mirë të rrezikut;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dhënia e rekomandimeve;
- Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të operacioneve, përfshirë ato jofinanciare;
- Monitorimi i zbatimit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Kontrolli i brendshëm është një proces i vazhdueshëm që synon arritjen e objektivave me integritet dhe pa kosto të panevojshme. Ai ndihmon në përgatitjen e informacionit të besueshëm dhe në kohë për vendimmarrje. Kontrollat ushtrohen në të gjitha nivelet e Shoqërisë për të zbutur rreziqet, dhe përfshijnë politika, procedura, sisteme dhe procese që:

- Janë të përshtatshme dhe të koordinuara me natyrën e rrezikut;
- Bëhen pjesë e aktivitetit të përditshëm dhe vendimmarrjes;
- Vlerësohen rregullisht për efektivitet;
- Përfshihen në një proces të gjerë sigurie dhe kontrolli.

Kontrollat klasifikohen në:

- **Parandaluese** — që synojnë shmangien e ngjarjeve të rrezikshme (p.sh. planifikimi dhe autorizimi);
- **Zbuluese** — që identifikojnë ngjarjet pas ndodhjes së tyre dhe ndihmojnë në marrjen e masave korrigjuese (p.sh. alarme dhe raportime të devijimeve).

Menaxhimi i riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri- tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

3.1 Rezultatet e marrjes në sigurim për vitin 2025

Shoqëria e sigurimit: ALBSIG JETE sh.a.				
Periudha e raportimit: VITI 2025				
LAT 2025(Liability Adequacy Test)	Jetë / Vdekje	Jetë ne grup	Jetë Skema "cash plan"	Total
Prime të fituara neto	716,004,963	29,261,097	22,566,545	767,832,605
Prime të shkruara bruto	880,901,800	50,673,494	7,482,959	939,058,252
Prime të ceduara në risigurim (-)	(106,279,738)			(106,279,738)
Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)	(145,499,823)	(21,412,397)	15,083,586	(151,828,634)
Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara, pjesa e risiguruesve (+/-)	86,882,724			86,882,724
Shpenzime neto për dëme të paguara	112,225,095	275,149	5,637,711	118,137,955
Dëme të paguara bruto	35,225,140	405,149	5,454,398	41,084,687
Dëme të paguara nga risiguruesit (-)	(16,517,157)			(16,517,157)
Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, bruto (+/-)	93,605,502	(130,000)	183,313	93,658,815
Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, pjesa e risiguruesve (+/-)	(88,390)			(88,390)
Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike	-			-
Shpenzime operative neto të veprimtarisë	511,825,347	11,815,229	3,435,925	527,076,501
Shpenzime të marrjes në sigurim	463,438,015	4,721,218	2,449,011	470,608,244
Ndryshimi në shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim (+/-)	(87,858,997)	(1,509,815)	(283,614)	(89,652,426)
Shpenzime administrative	149,567,863	8,603,826	1,270,528	159,442,217
Komisione të risigurimit (-)	(13,321,534)			(13,321,534)
Komisione të risigurimit (-)	(15,694,882)			(15,694,882)
Rezultati teknik	91,954,521	17,170,719	13,492,909	122,618,149
Raporti dëme prime neto	16%	1%	25%	15%
Raporti shpenzimeve	71%	40%	15%	69%
Raporti i kombinuar	87%	41%	40%	84%

Duke u bazuar testi i rezultateve të marrjes në sigurim sipas produkteve dhe portofoleve si më poshtë për vitin 2025:

Produkti i Jetës së debitorit ka raport të lartë të shpenzimeve, jashtë diapazonit normal.

- Ky raport do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

Produkti Sigurimi i Jetës në grup – Konstatohet se ka raport të lartë të shpenzimeve, jashtë diapazonit normal, si rrjedhojë e shpenzimeve administrative.

- Ky raport do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

Sigurimi sipas skemave 'cash plan' – Konstatohet se ka raport të shpenzimeve brenda diapazonit normal.

- Megjithatë ky raport do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.

Raporti i kombinuar në total është 84% për vitin 2025 nga 72 % që ishte për vitin 2024.

3.2 Toleranca dhe kufijtë e riskut

Toleranca ndaj riskut përcaktohet nga objektivat strategjike të shoqërisë. Objektivat strategjike të shoqërisë janë të lidhura kryesisht me objektivat e rritjes në treg, marzhet e synuara të fitimit dhe mbajtjen e një niveli kapitali mbi një marzh të caktuar. Në këto objektiva është përcaktuar si qëllimi i pozicionimit në treg në pjesmarrje, ashtu dhe në raport me cilësinë e shërbimit. Matësit e nivelit të riskut që përdoren kryesisht janë kufijtë gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu dhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit. Shoqëria ka manual dhe procedura të hartuara për këtë qëllim. Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi Surplus Treaty dhe Quota Share në mbrojtje të kapitalit.

3.3 Kufijtë për risigurim

Shoqëria Albsig Jetë Sh.a. ka politika të risigurimit që kanë për qëllim përcaktimin e kriterëve dhe metodikën mbi bazën e të cilave lidhen programet e marrëveshjeve të risigurimit në mënyrë që aktiviteti sigures i shoqërisë të veprojë në një mjedis të sigurt, të qëndrueshëm dhe transparent, në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të biznesit nga risqe të ndryshme, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Shoqëria Albsig Jetë Sh.a. risiguron të gjitha risqet apo pjesë të përgjegjësisë që ka kontraktuar me të siguruarit që tejkalojnë mbulimin maksimal të shoqërisë, të masës 10% të Aftësisë Paguese të shoqërisë Albsig Jetë Sh.a. Marrëveshjet e risigurimit janë nënshkruar vetëm me shoqëritë e risigurimit që përmbushin kushtet sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

3.4. Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë.

Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregullatore në çdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e risqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së siguruar, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2025 vlera e fondit të garancisë është brenda të gjitha normave të kërkuara.

3.5. Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" aktivet në mbulim të provigjoneve teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Aktivet që mbulojnë provigjonet teknike për periudhën e fund vitit 31 Dhjetor 2025:

Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt
Aktivët e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		475,308,395
d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	19,354,000
f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	15,000,000
gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14;	30%	197,105,595
Qëllime investimi		197,105,595
Objekti 1	10%	197,105,595
h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	243,848,800
Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		493,080,033
c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	26,471,623
d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	165,250,262
f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjonit të primit të pafituar;	20%	131,545,484
g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	11,525,761
h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	9,957,009
j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	148,329,893
j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	100%	
j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	41,109,354
TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		968,388,428
TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		640,220,514
C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		495,651,054
Provigjone të primit të pafituar		316,714,414
Provigjone të dëmeve		178,936,640
Tepriçë (+) / Mungesë (-) (V-VI)		144,569,460
Mbulimi në % (V/VI)		129.17%

3.6. Mjaftueshmëria e kapitalit

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	834,689,157
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	432,254,000
I.c	Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	403,361,906
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	926,749
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	926,749
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	-
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	118,401,858
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	69,000,000
V	Aktivet jolikuide (V.a deri V.g)	49,401,858
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90- ditor;	48,351,858
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	1,050,000
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	716,287,298
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	240,228,480
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	346,287,298
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

Stres-testet janë përgjithësisht përcaktuar duke iu referuar lëvizjeve në parametrat financiarë kryesorë (të tilla si normat e interesit, vlera e aktiveve ose vlerat e detyrimit), ndërsa testet e skenarëve mund t'u referohen shkaqeve të zhvillimeve negative, të tilla si katastrofat materiale natyrore apo incidentet me të mëdha industriale. Stres-testet duhet të jenë të përshtatura në profilin e tyre të riskut. Për këtë qëllim, duhet të identifikojnë risqet e mundshme afatshkurtra dhe afatgjata dhe ngjarjet e mundshme apo ndryshimet e ardhshme në kushtet ekonomike që mund të ketë një efekt të pafavorshëm në gjendjen e përgjithshme financiare për të përcaktuar ndikimin tek kapitali.

Analizat e Skenarëve duhet të bazohen në një sërë ngjarjesh, duke përfshirë ngjarjet ekstreme por të mundshme, dhe të marrë parasysh ndonjë efekt material të cilat mund të lindin. Stres-testet janë ato që kërkojnë të vlerësojnë skenarët dhe rrethanat që do të bëjnë modelin e biznesit të paqëndrueshëm, duke identifikuar dobësitë e mundshme të biznesit. Testimi i stresit të kundërt fillon nga një rezultat i modelit të biznesit dhe identifikon rrethanat në të cilat kjo mund të ndodhë.

- **Risku i sigurimit:** një pandemi ku shoqëria ka ekspozim të madh ndaj tyre;
- **Risku i kreditit:** dështimi i një risiguruesi dhe/ose banke me ekspozim të lartë;
- **Risku operacional:** përzgjedhja e metodës së provigjonimit të dëmeve dhe ndikimi i diferencave me rezultatin e metodës së audituesit të pavarur, probleme me sistemin e shitjes së policave të sigurimit;
- **Risku i tregut:** zhvlerësim i monedhës Lekë ndaj monedhave të huaja Euro, Dollarë;
- **Risku i likuiditetit:** mosrinovim në masën 30% të kontratave në një nga portofolet kryesore si Jeta e debitorit.

4.1 Vetëvlerësimi i riskut, ORSA

Orsa mund të përkufizohet si "tërësia e proceseve dhe procedurave të përdorura për të identifikuar, vlerësuar, monitoruar, menaxhuar, dhe raportuar në kohë afatshkurtër dhe riskun afatgjatë. Orsa kërkon menaxhimin për të marrë parasysh vlerësimin e tyre të risqeve dhe kapitalit të shoqëruara ekonomikisht si të nevojshme për të përmbushur objektivat strategjike.

Orsa duhet të lejojë që menaxhimi të marrë një kuptim të vërtetë dhe praktik të risqeve të ekspozuar ose mund të përballet me të ardhmen, si kapitalin dhe veprimet lehtësuese të nevojshme për të mbuluar këto risqe. Si e tillë Orsa duhet të marrë parasysh proceset e riskut, kapitalit, të performancës dhe strategjisë dhe duhet të sigurojë menaxhimin me informata të nevojshme për të marrë vendime të rëndësishme në lidhje me profilin e përgjithshëm të riskut dhe kapitalit. Orsa shihet si një proces i vazhdueshëm, e jo thjesht një pikë në raportin kohor që mbulon procesin.

Qëllimi kryesor i Orsa është që të sigurojë menaxhimin me një mekanizëm përmes të cilit Këshilli Mbikëqyrës dhe menaxhimi mund të vlerësojnë risqet me të cilat përballen për të përcaktuar nivelin e kapitalit ekonomik të nevojshëm për të përmbushur objektivat strategjike.

Menaxhimi duhet të ketë procese në vend që mbështesin Orsa duke siguruar informacionin e kërkuar për të marrë vendime të rëndësishme në lidhje me profilin e përgjithshëm të riskut dhe kapitalit. Planifikimi i kapitalit duhet të konsiderohet si afat shkurtër dhe afat gjatë dhe duhet të konsiderojë alternativat për të siguruar që kërkesat e kapitalit mund të plotësohen edhe në rrethana të papritura negative. Përcaktimi i nevojave të përgjithshme të Aftësisë paguese duhet të kontribuojnë në vlerësimin nëse do të mbajë apo të transferojë risqet.

Vlerësimi i aftësisë paguese nevojitet që:

- Të pasqyrojë praktikën e menaxhimit, sistemet dhe kontrollet, duke përfshirë përdorimin e teknikave të zbutjes së riskut;
- Të vlerësojë cilësinë e proceseve dhe inputeve, në mënyrë të veçantë përshtatshmërinë e sistemit të saj të qeverisjes, duke marrë parasysh risqet që mund të lindin nga mangësitë.
- Të lidhi planifikimin e biznesit me aftësisë paguese të nevojshme.
- Të përfshijë identifikimin e qartë të skenarëve të mundshme në të ardhmen.
- Të trajtojë stresin e potencialit të jashtëm.

Dhe

- Të marrë parasysh veprimet e menaxhimit të cilat mund të miratohen në rrethana të vështira.

4.2 Teste të paralajmërimit të hershëm

Bazuar në sistemin e treguesve të paralajmërimit të hershëm, është vërejtur se:

Raporti i mbajtjes neto është në masën 88.68%.

Ky raport është në nivelin e kufijve të lejuar.

Raporti i kombinuar për shoqërinë është në masën 84.03 %, tregues ky i rezultatit financiar pozitiv të shoqërisë në aktivitetin operacional.

Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti dëme/prime neto për shoqërinë në 31.12.2025 është 15.39%

Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti i shpenzimeve në 31.12.2025 është në masën 68.64%

Ky raport tejkalon normat e përcaktuara ndërkombëtare. Në strukturën e shpenzimeve të shoqërisë shpenzimet e marrjes në sigurim të veprimtarisë janë në masën 49.61 % dhe në masën 19.03 % shpenzimet administrative të veprimtarisë së shoqërisë. Shoqëria do të monitorojë me kujdes të madh të gjitha elementet që përbëjnë shpenzimet administrative dhe pavarësisht konkurrencës së fortë në treg për marrjen në sigurim të monitorohen me kujdes të gjitha elementet e shpenzimeve të marrjes në sigurim duke filluar që nga pagat që lidhen me marrjen në sigurim dhe komisionet.

Risqet e analizuar gjatë vetëvlerësimit janë të kategorizuara si më poshtë:

Analiza e risqeve të lidhura me aktivitetin:

➤ Risku i marrjes në sigurim

Analizat e tarifimit të produkteve (raporte dëme/prime, raporte shpenzime/prime etj) bëhen me bazë 3 — mujore nga aktuari i shoqërisë për produkte të cilat konsiderohen me risk të lartë si Jeta e debitorit etj. Në lidhje me programin e risigurimit për cdo vit shoqëria siguron mbulimin e nevojshëm dhe transferimin e rrezikut që shoqëria nga analizat ka vendosur të mos mbajë. Varësia nga ndërmjetësit në sigurime si brokera, banka, agjensi udhëtimesh është në nivele të konsiderueshme.

➤ Risku i provigjionimit

Provigjonet në fund të vitit 2025 janë testuar nga aktuari i auditorit të jashtëm dhe aktuari shoqërisë dhe kanë rezultuar se janë të mjaftueshme për mbulimin e detyrimeve që ka shoqëria.

Plani i vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara vlerësohen nga shoqëria Albsig Jetë sh.a. si një risk, i cili duhet administruar me shumë kujdes, nisur nga varësia ndaj sistemeve të IT. Shoqëria i jep rëndësi këtij risku, sepse në rastin e një katastrofe duhet të garantojë vazhdimësinë operationale të saj dhe ti përgjigjet në kohë dhe shpejtësi kërkesave të klientëve për dëmshpërblim. Shoqëria e ka në objektivin e saj për përmisime cilësore të mëtijshme.

E rëndësishme është për të qënë në monitorim të qëndrueshëm për të gjitha fushat e riskut.

Për këtë shoqëria është gjithmonë fokusuar në ndërmarrjen e masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm.

Shoqëria gjithmonë ka një parim se menaxhimi i Riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/ trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.



Shoqëria është e fokusuar në një raportim efektiv të informacionit kyç të riskut të qeverisjes për të siguruar që personat e përfshirë të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë në konsideratë në procesin e vendimmarrjes. Një punë e vazhdueshme nga shoqëria është dhe ngritja e nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve në përgjithësi dhe në vecanti me çështjet që janë të lidhura me menaxhimin e riskut. Kjo realizohet me anë të seminareve, trajnimeve etj.

Planet e veprimit janë zhvilluar në mënyrë tipike dhe zbatuar për të adresuar nivele të papranueshme të riskut dhe / ose riparimin e dobësive të kontrollit. Duhet të marrin në konsideratë se si proceset e sigurimit të mund të sigurojnë funksionimin efektiv të kontrolleve dhe zbatimin e planeve të veprimit. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi. Nëse risku mund të ndikojë në aktivitetin e dy, ose më shumë njësive, ky plan duhet të miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

6.1 Opinioni i Auditorit të Jashtëm



RSM
RSM ALBANIA
Rr. Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3-hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Aksionarin e Shoqërisë Albsig Jetë Sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë Albsig Jetë Sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2025, si dhe pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbylltur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare individuale, përfshirë një përmbletje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbyllur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SHUP.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç së më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezultojnë nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 25/2018 Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, përveç pasqyrave financiare individuale dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2025 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që joo siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare individuale, ne kemi përgjegjësi në të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njëqjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomalitë materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Nëse arrijmë në përfundimin se ka një gabim material në të, ne jemi të detyruar t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen.

Raportet e tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e skeduleve shoqërore plotësuese të Aktitësive Paguese dhe Aktiveve për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("skedule plotësuese") në përputhje me ligjin "Për vopprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoriteteve të Mbledhjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar skedulet plotësuese shoqërore. Këto skedule plotësuese të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare individuale. Informacioni historik financiar, i parashit në skedulet shtesë të këtyre pasqyrave financiare individuale, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2025, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor
RSM Albania



Tiranë, 20 prill 2025

6.2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar

ALBSIG JETË SHA

Pasqyra individuale e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Aktivët			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	26,471,623	46,763,846
Depozita me afat me bankat	7	623,805,809	554,286,459
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	8	179,897,343	82,498,895
Aktive të risigurimit	9	165,250,262	78,279,148
Të tjera llogari të arkëtueshme	10	1,050,003	1,120,870
Investime në tituj borxhi	11	34,354,000	34,630,000
Kosto të shlyra të marrjes në sigurim	12	148,329,893	58,677,467
Aksione në shoqëri të lidhura	13	69,000,000	69,000,000
Aktive afatgjata materiale	14	208,631,356	95,333,799
Aktive afatgjata jomateriale	15	926,749	1,237,958
Totali i aktiveve		1,457,717,038	1,021,828,442
Detyrimet			
Rezervat për primet e paguar	16	316,714,413	164,885,780
Rezerva teknike për dëmet	17	178,936,640	85,277,825
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	18	-	450,000
Detyrim tatim fitimi	28	3,180,904	2,126,362
Detyrime të tjera	19	123,269,172	56,168,052
Totali i detyrimeve		622,101,129	308,908,019
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	432,254,000	432,254,000
Fitime të mbartura		280,666,423	184,074,795
Fitimi i ushtrimit		122,695,486	96,591,628
Totali i kapitalit		835,615,909	712,920,423
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		1,457,717,038	1,021,828,442

Shënimet shpjeguese në faqet 5-34 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare individuale.

6.3. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse

ALBSIG JETË SHA

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2025 (Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Prime të shkruara bruto	21	939,058,252	500,130,722
Prime të çeduar në risigurim	22	(89,762,580)	(55,921,730)
Prime të shkruara neto		849,295,672	444,208,992
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara	16	(151,828,634)	(43,351,030)
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguresit	9	86,882,724	8,643,580
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		784,349,762	409,501,542
Të ardhura nga interesi	23	17,626,617	17,059,899
Të ardhura të tjera		13,484,568	15,849,050
Të ardhura të tjera		31,111,185	32,908,949
Të ardhurat neto		815,460,947	442,410,491
Dëme të paguara të sigurimit	24	(41,084,687)	(36,542,555)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve	17	(93,658,815)	(42,689,433)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguresit	9	88,390	27,790,548
Dëme të sigurimit neto		(134,655,112)	(51,441,440)
Kostot e manjes në sigurim	25	(170,608,244)	(196,809,990)
Ndryshimi në shpenzime të shlyra	12	89,652,426	17,568,114
Shpenzimet administrative	26	(159,442,217)	(78,797,605)
Të ardhura financiare neto	27	4,035,825	(19,147,607)
Total shpenzime operative		(536,362,210)	(277,187,088)
Fitimi i vitit para tatimit		144,443,625	113,781,963
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	28	(21,748,139)	(17,190,335)
Fitimi i vitit pas tatimit		122,695,486	96,591,628
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		122,695,486	96,591,628

Shënimet shpjeguese në faqet 5-34 janë pjesë e pondarë e këtyre pasqyrave financiare individuale.

6.4. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

ALBSIG JETE SHA

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital me 31 dhjetor 2025

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Fitimi i mbartur	Fitim i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	432,254,000	105,191,371	78,883,424	616,328,795
Pagesa e kapitalit të papaguar	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	96,591,628	96,591,628
Transferim në fitime të mbartura	-	78,883,424	(78,883,424)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	432,254,000	184,074,795	96,591,628	712,920,423
Emetim kapitali aksionar	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	122,695,486	122,695,486
Transferim në fitime të mbartura	-	96,591,628	(96,591,628)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2025	432,254,000	280,666,423	122,695,486	835,615,909

Shënimet shpjeguese në faqet 5-34 janë pjesë e pandare e këtyre pasqyrave financiare individuale. Pasqyrat financiare u aprovuan nga drejtimi i Shoqërisë Albsig Jetë sha, më 7 prill 2026 dhe u firmosën nga:



Z. Ervin Spahiu
Drejtor i Përgjithshëm



Z. Ilfan Lami
Drejtor i Financës

6.5. Pasqyra individuale e flukseve monetare

ALBSIG JETE SHA

Pasqyra individuale e flukseve të parase për periudhën që mbyllet më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Flukset monetare nga aktivitetet operative			
Fitimi neto para tatimit		144,443,625	113,781,964
<i>Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	15,16	13,629,421	1,477,788
Të ardhurat nga interesi	21	(17,626,617)	(17,059,899)
Shpenzim tatimi mbi fitimin	27	(21,748,139)	(17,190,335)
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		118,698,290	81,069,518
<i>Ndryshimet në:</i>			
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto		(97,398,448)	(32,136,376)
Aktive të risigurimit		(86,971,114)	(36,434,128)
Të tjera llogari të arkëtueshme		70,867	1,049,377
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura		-	12,777
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim		(89,652,426)	(17,568,114)
Rezervat për primet e pafitur		151,828,634	43,351,030
Rezerva teknike për dëmet		93,658,815	42,689,433
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		(450,000)	(2,847,238)
Detyrim tatim fitimi		1,054,542	(1,177,411)
Detyrime të tjera		67,101,119	20,839,010
Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative		157,940,279	98,787,878
<i>Flukset monetare nga aktivitetet investuese:</i>			
Blerje të aktiveve afatgjata material dhe jo materiale	14,15	(126,615,769)	(78,001,522)
Depozita me afat me bankat		(51,892,733)	(7,104,245)
Investime në shoqëri të lidhura		276,000	1,146,000
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese		(178,232,502)	(83,959,767)
Fluksi monetare nga veprimtaritë e financimit			
Emetim i kapitalit aksionar		-	-
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaritë		-	-
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë		(20,292,223)	14,828,111
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit		46,763,846	31,935,735
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	6	26,471,623	46,763,846

Shënime shpjeguese në faqet 5-34 janë pjesë e pandarë e këtyre pasqyrave financiare individuale.

6.6. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale

ALBSIG JETE SHA

Skedalet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
Aktivet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		475,308,395		147,540,490
d) Obligacione dhe tituj të tjerë bordi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	19,354,000	3.9%	-
f) Kuota/nksione të sipërmarreve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	15,000,000	3.0%	-
gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, përveç gj) e Ligjit 52/14:	30%	197,105,595	39.8%	147,540,490
<i>Qëllime investimi</i>		<i>197,105,595</i>		<i>147,540,490</i>
<i>Objekti 1</i>	10%	<i>197,105,595</i>	<i>39.8%</i>	<i>147,540,490</i>
h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	243,848,800	49.2%	-
Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-		-
Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, datë 28.04.2015, nenit 4:		493,080,033		180,627,424
c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	26,471,623	5.3%	11,602,092
d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	165,250,262	0.0%	-
f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjontit të primit të paguar;	20%	131,545,484	41.5%	68,202,602
g) Aktive të qëndrueshme të mupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	11,525,761	2.3%	-
h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	9,957,009	2.0%	-
j) Shpenzimet e manjes në sigurim të shtyra	15%	148,329,893	46.8%	100,822,731
TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		968,388,428		328,167,914
TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		640,220,514		-
C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		495,651,054		
<i>Provigjone të primit të paguar</i>		<i>316,714,414</i>		
<i>Provigjone të dëneve</i>		<i>178,936,640</i>		
Tepriçë (+) / Mungesë (-) (V-VI)		144,569,460		
Mbulimi në % (V/VI)		129.17%		

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Kufiri minimal i aftësisë paguese

	Albsig Jete	31.12.2025
1	1. Kufiri minimal i aftësisë paguese për kontratat që nuk lidhen me fonde të investimeve	
2	<i>Llogaritja e parë</i>	
3	Provizionet matematike bruto në fund të periudhës	0
4	Provizionet matematike neto në fund të periudhës	0
5	Raporti i risigurimit ($5 = \max(0.85, 4/3)$)	0.85
6	Koeficienti i pasigurisë ($6 = 0.04$)	0.04
7	Rezultati nga llogaritja e parë ($7 = 3 * 5 * 6$)	0
8	<i>Llogaritja e dytë</i>	
9	Vlera e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat 5 vjet ose më shumë	8,549,415,200
10	Vlera e e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat 5 vjet ose më shumë	7,451,088,411
11	Vlera e e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat 3 vjet ose më shumë, por më të vogël se 5 vjet	6,492,573,029
12	Vlera e e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat 3 vjet ose më shumë, por më të vogël se 5 vjet	3,881,368,227
13	Vlera e e kapitalit në rrezik bruto për kontratat me afat më të vogël se 3 vjet	129,249,029,445
14	Vlera e e kapitalit në rrezik neto për kontratat me afat më të vogël se 3 vjet	77,960,004,851
15	raporti i mbajtjes ($15 = \max(0.50(10+12+14)/(9+11+13))$)	0.62
16	koeficienti i pasigurisë d1 ($16 = 0.003$)	0
17	koeficienti i pasigurisë d2 ($17 = 0.0015$)	0.0015
18	koeficienti i pasigurisë d3 ($18 = 0.001$)	0.001
19	Rezultati nga llogaritja e dytë ($19 = 9 * 15 * 16 + 11 * 15 * 17 + 13 * 15 * 18$)	101,882,750
20	Kufiri minimal i aftësisë paguese për kontratat që nuk lidhen me fondet e investimeve ($20 = 7 + 19$)	101,882,750
21	2. Kufiri minimal i aftësisë paguese për sigurime suplementare	
22	primet të shkruara bruto nga aktiviteti i sigurimeve	939,058,252
23	primet të shkruara bruto nga aktiviteti i risigurimeve	
24	taksa të zbritshme	62,437,732
25	shuma "a" ($25 = 22 + 23 - 24$)	876,620,520
26	Pjesa e shumës "a" më e vogël se 1,000,000,000 Lekë ($26 = \min(1,000,000,000, 25)$)	876,620,520
27	Pjesa e shumës "a" më e madhe se 1,000,000,000 lekë ($27 = 25 - 26$)	0
28	Koeficienti i pasigurisë b1 ($28 = 0.18$)	0.18

II

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Albsig Jete	31.12.2025
29	Koeficienti i pasigurisë b2 (29=0.16)	0.16
30	dëme të paguara bruto	41,084,687
31	pjesa e risiguruesit në dëmet e paguara	16,517,157
32	Dëme të paguara neto (32=30-31)	24,567,530
33	provigjone bruto të dëmeve në periudhën aktuale	178,936,640
34	provigjone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar	85,277,825
35	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në periudhën aktuale	33,700,249
36	pjesa e risiguruesve në provigjonet e dëmeve në fund të vitit të kaluar	33,611,860
37	provigjone neto të dëmeve në periudhën aktuale (37=33-35)	145,236,391
38	provigjone neto të dëmeve në fund të vitit të kaluar (38=34-36)	51,665,965
39	ndryshimi në provigjonet e dëmeve bruto (39=33-34)	93,658,815
40	ndryshimi në provigjonet neto të dëmeve (40=37-38)	93,570,426
41	dëme të ndodhura bruto (41=30+39)	134,743,502
42	dëme të ndodhura neto (42=32+40)	118,137,956
		0.88
43	raporti i mbajtjes (43=max(0.50,42/41))	0.88
	Kufiri minimal i aftësisë paguese për sigurimet suplementare	
44	(44=(28*26+29*27)*43)	138,345,730
	3. Kufiri i aftësisë paguese për kontrata të lidhura me fonde të investimeve	
45		
46	<i>Llogaritja e parë</i>	
51	raporti i mbajtjes (51=max(0.85,(49+50)/(47+48)))	0.85
52	koeficienti i pasigurisë d1 (52=0.04)	0.04
53	koeficienti i pasigurisë d2 (53=0.01)	0.01
54	Rezultati i llogaritjes së parë (54=47*51*52+48*51*53)	0
55	<i>Llogaritja e dytë</i>	
58	raporti i mbajtjes(58=max(0.5,57/56))	0.50
59	koeficienti i pasigurisë (59=0.003)	0.003
60	Rezultati i llogaritjes së dytë(60=56*58*59)	0
	Kufiri i aftësisë paguese për kontrata të lidhura me fonde të investimeve (61=54+60)	0
62	Kufiri minimal i aftësisë paguese (62=20+44+61)	240,228,480

III

ALBSIG JETE SHA

Skedulet plotësuese

(Shumat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Mjaftueshmëria e kapitalit

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (La+Lb+Lc-II)	834,689,157
	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuar;	432,254,000
L.a		
L.c	Fitim i pasipërdarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	403,361,906
	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë:	
II	(II.a+II.b+II.c+II.d)	926,749
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	926,749
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.d)	-
	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14	
IV	(IV.a+IV.b+IV.c+V)	118,401,858
	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	69,000,000
IV.a		
V	Aktivët jollkuide (V.a deri V.g)	49,401,858
	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90-ditor;	48,351,858
V.d		
	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	1,050,000
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	716,287,298
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	240,228,480
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	346,287,298
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

7 AUDITIMI I BRENDSHËM

7.1 Objektivi dhe qëllimi i Auditimit të Brendshëm

Auditimi është një aktivitet i pavarur dhe objektiv konsulence për të dhënë siguri dhe udhëhiqet nga parimi për të shtuar vlerë në përmirësimin e operacioneve të "Albsig Jetë" sh.a. (Shoqëria). Qëllimi i këtij raporti është evidentimi i ecurisë së punës dhe angazhimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2025, bazuar në planin e Auditimit të Brendshëm për vitin 2025 dhe Kontratës nr. 02/1, datë 06.01.2020 "Për delegimin e disa funksioneve të shoqërise Albsig Jetë sh.a.". Objektivi kryesor i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është të sigurojë përputhshmërinë me zbatimin e ligjit, akteve nënligjore, si dhe rregulloret e brendshme rregullative në veprimtarinë e shoqërisë "Albsig Jeta" sh.a. Objektiv tjetër i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është të veprojë si një mjet kontrolli i përgjithshëm dhe shërbim konsulence për Administratorët dhe Këshillin Mbikëqyrës, duke dhënë ndihmesën e tij në drejtim të ruajtjes së integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

7.2 Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Kartën e Auditimit të Brendshëm, e cila përshkruan misionin, qëllimin, objektivat e punës dhe përgjegjësinë e funksionit të auditimit të brendshëm të Shoqërisë. Gjithashtu, njësia ka plotësuar kërkesat e rregullores "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit" miratuar me vendimin e Bordit, nr. 153, datë 23.12.2014 dhe ka ndjekur praktikatat më të mira ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Auditimit të Brendshëm. Bazuar në historikun e deritanishëm të kompanisë, duke konsideruar proceset më të rëndësishme të aktivitetit të Shoqërisë, por edhe duke u bazuar në analizën e rifreskuar të riskut për kompaninë, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar planin vjetor të Auditimit.

7.3 Pohimi për pavarësinë

Aktiviteti i auditimit të brendshëm ka qënë i pandikuar nga ndërhyrje për mënyrën e organizimit, si dhe nga çdo ndërhyrje në lidhje me përcaktimin e qëllimit, procedurave, shpeshtësisë së kontrollit, apo përmbajtjen e raportit të auditimit. Audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka shfaqur nivel të lartë të gjykimit profesional dhe objektiv në mbledhjen, vlerësimin dhe komunikimin e informacionit mbi proceset, të cilat kanë qënë subjekt auditimi. Njëkohësisht, audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka ushtruar një gjykim të balancuar, duke shqyrtuar të gjithë rrethanat e duhura dhe nuk është influencuar nga interesi personal.

7.4 Struktura organizative dhe raportimi

Auditimi i Brendshëm, sipas organizimit të Shoqërisë, raporton tek Komiteti i Auditimit, Këshilli Mbikëqyrës dhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë. Për kualifikimin e vazhdueshëm në fushën e Auditimit të Brendshëm, personeli i departamentit është angazhuar dhe ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme trajnimi, certifikimi dhe programe profesionale në fushën e auditimit të brendshëm.

7.5 Opinioni i Audituesit të Brendshëm

Si rezultat i kryerjes së aktiviteteve të auditimit të brendshëm, për vitin 2025, përveç çfarë është raportuar vazhdimisht për tematika të veçanta, **nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.** Janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procedurave, administrimin e informacionit e dokumentimit, si dhe të proceseve të ndryshme fokusuar në risk.

Auditimi i Brendshëm
Arlinda Poga

8.1 Pjesëmarrja në "FSHN-UT Open Day".

Eksperiencë – Karrierë", të organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ky event mbledhi një audiencë të gjërë studentësh dhe profesionistësh të fushave të ndryshme, duke ofruar një mundësi ideale për ndërveprim të drejtpërdrejtë me të rinjtë që kërkojnë mundësi praktike, punësimi apo bashkëpunimi.

ALBSIG prezantoi produktet dhe shërbimet e saj në një stendë të dedikuar, ku u shpërndanë materiale informuese dhe promovuese. Gjatë gjithë aktivitetit, përfaqësuesit tanë ishin në kontakt të vazhdueshëm me pjesëmarrësit, duke dhënë informacione të dobishme mbi fushën e sigurimeve dhe mundësitë e karrierës që kompania jonë ofron. 04 Në datën 23 Prill 2025, ALBSIG mori pjesë në panairin "FSHN-UT Open Day, Studim – Eksperiencë – Karrierë", të organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.



Ky event mbledhi një audiencë të gjërë studentësh dhe profesionistësh të fushave të ndryshme, duke ofruar një mundësi ideale për ndërveprim të drejtpërdrejtë me të rinjtë që kërkojnë mundësi praktike, punësimi apo bashkëpunimi. ALBSIG prezantoi produktet dhe shërbimet e saj në një stendë të dedikuar, ku u shpërndanë materiale informuese dhe promovuese. Gjatë gjithë aktivitetit, përfaqësuesit tanë ishin në kontakt të vazhdueshëm me pjesëmarrësit, duke dhënë informacione të dobishme mbi fushën e sigurimeve dhe mundësitë e karrierës që kompania jonë ofron.

8.2 Albsig, një mundësi për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2025

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, mori pjesë në "Panairin e Punës dhe Karrierës 2025" të organizuar nga Fakulteti i Biznesit, UAMD. Albsig mirëpriti studentë e të rinj të interesuar për mundësi punësimi dhe praktika profesionale, shumë prej të cilëve shprehën interes për t'u bërë pjesë e stafit ose për të ndjekur internshipet e kërkuara nga programet akademike.

Aktivitetet të tilla, theksojnë rëndësinë e përafrimit të arsimit me tregun e punës. Pjesëmarrja e personaliteteve të ndryshme prezent, e shtoi edhe më tej rëndësinë e këtij aktiviteti tashmë tradicional, duke siguruar që studentët të jenë gati për sfidat e ardhshme profesionale. Albsig mbetet një mbështetës i fuqishëm i brezit të ri dhe promovimit të karrierës së tyre.



8.3 Albsig në Panairin e Karrierës të Western Balkans University

Western Balkans University, në bashkëpunim me Dhomën Britanike të Tregtisë në Shqipëri, organizoi edicionin e dytë të Panairit të Karrierës, që solli së bashku mbi 60 biznese dhe institucione për t'u ofruar studentëve një pasqyrë reale të botës së punës. Albsig, pjesë e Kastrati Group, ishte krenare të ishte pjesë e këtij aktiviteti, duke sjellë në stendën e saj eksperiencën dhe energjinë e një ekipi të përkushtuar. Studentët e WBU u treguan mjaft të interesuar për mundësitë e internshipeve dhe bashkëbiseduan me ekspertët tanë për të kuptuar më mirë si mund të integrohen në tregun e punës. Për shumë prej tyre, ky panair ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt një karriere të suksesshme. Albsig, si gjithmonë, mbështet iniciativat që nxisin zhvillimin profesional të të rinjve dhe i orienton ata drejt mundësive konkrete për praktikë dhe punësim.




8.4 ALBSIG organizon një ditë dhurimi gjaku në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Në kuadër të angazhimit të vazhdueshëm për përgjegjësi sociale dhe mbështetje ndaj komunitetit, ALBSIG organizoi në ambientet e drejtorisë qendrore një aktivitet dedikuar dhurimit vullnetar të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar.

Nën moton **“Dhuro gjak, shpëto jetë”**, punonjës të kompanisë u bënë pjesë aktive e një procesi jetik për sistemin shëndetësor në vend. Dhurimi i gjakut është një ndër aktet më domethënëse të solidaritetit dhe një nevojë e vazhdueshme për trajtimin e pacientëve që përballen me emergjenca mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale, apo sëmundje kronike.

Përmes kësaj iniciative, ALBSIG synon të përçojë mesazhin se secili prej nesh mund të bëjë një ndryshim të vërtetë në jetën e dikujt, me një akt të thjeshtë, por me ndikim të madh. Nisma është pjesë e kalendarit të veprimtarive të kompanisë që mbështesin kauza sociale dhe kontribuojnë në mirëqenien kolektive. Ne e shohim përgjegjësinë sociale jo thjesht si pjesë të identitetit tonë korporativ, por si një detyrim moral për të qenë pranë komunitetit në momente dhe forma që kanë rëndësi reale. Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar ka qenë thelbësor për realizimin e kësaj dite, duke siguruar standardet e duhura mjekësore, ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e stafit në një atmosferë organizative shembullore.





ALBSIG mbetet e angazhuar për të vijuar mbështetjen e kauzave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës në shoqëri, duke fuqizuar rolin e saj si një kompani që kujdeset jo vetëm për sigurinë financiare, por edhe për jetën.

8.5 ALBSIG për Tetorin Rozë. Kujdes, ndërgjegjësim dhe mbështetje — sepse shëndeti fillon me kujdesin ndaj vetes

Në kuadër të Tetorit Rozë dhe si pjesë e traditës së përvitshme të ALBSIG, janë mundësuar kontrolle falas për eko gjiri pranë Klinikës Wellness për të gjitha koleget e shoqërisë. Kjo nismë vjen si pjesë e angazhimit të ALBSIG për të mbështetur ndërgjegjësimin mbi parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm të kancerit të gjirit, një kauzë me rëndësi të veçantë për komunitetin dhe shëndetin e grave. Për ALBSIG, kujdesi ndaj shëndetit nuk është vetëm përgjegjësi personale, por një vlerë që përqafojmë së bashku. Kjo mundësi e ofruar për stafin tonë është shprehje e bindjes se parandalimi dhe kontrolli i rregullt janë hapat më të rëndësishëm drejt shëndetit dhe jetës së sigurt.



Çdo vit, ALBSIG e përforcon këtë traditë si shenjë solidariteti, kujdesi dhe mbështetjeje, duke kujtuar se shëndeti i çdo gruaje është një prioritet që na bashkon të gjithëve. Sepse në ALBSIG, kujdesi është pjesë e kulturës sonë — dhe çdo hap i vogël për shëndetin, është një hap i madh për jetën.

Tetori është muaji i ndërgjegjësimi për luftën kundër kancerit të gjirit, një kauzë që çdo vit na kujton rëndësinë e kujdesit, kontrollit dhe parandalimit. Në kuadër të Tetorit Rozë, ALBSIG zhvillon një fushatë ndërgjegjësimi me moton: “Në ndihmë të vajzave dhe grave për diagnostikimin sa më të hershëm të çdo problematike shëndetësore, me fokus në kancerin e gjirit.” Ky muaj mbart një mesazh të fortë solidariteti dhe kujdesi, duke ftuar çdo vajzë e grua të marrë kohën për t’u informuar dhe për të bërë kontrollet periodike.

Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm shpëtojnë jetë. Në shenjë sensibilizimi dhe mbështetjeje, ALBSIG — pjesë e Kastrati Group — bashkohet edhe këtë vit me fushatën Tetori Rozë, duke qenë përkrah çdo gruaje në këtë betejë të rëndësishme për shëndetin dhe jetën. Sepse shëndeti është pasuria më e çmuar, dhe kujdesi për veten është hapi i parë drejt një të ardhmeje të sigurt. Ne në ALBSIG besojmë se siguria nuk kufizohet vetëm te pasuritë dhe asetet materiale — ajo fillon nga shëndeti. Prandaj, ju inkurajojmë që gjatë këtij muaji të bëni kontrollin e gjirit dhe ta bëni këtë një pjesë të zakonshme të kujdesit tuaj personal.



9.1. Pashka në Albsig Harmoni, traditë dhe momente të paharruara

Festat janë më shumë sesa një shënim në kalendar — ato janë një mundësi për t'u ndalur, për të reflektuar dhe për të krijuar kujtime të bukura së bashku. Në Albsig, e kemi kthyer tashmë në traditë që çdo festë të shërbejë si një moment për të forcuar lidhjet midis nesh dhe për të rikujtuar vlerat që na bashkojnë. Me rastin e Pashkëve, stafi ynë u mbledh në ambientet e ngrohta të @foodlovers_al për të festuar në një atmosferë të qetë dhe plot ngjyra. Ngjyrosja e vezëve, një simbol i kësaj feste, u kthye në një aktivitet që solli jo vetëm krijimtari, por emocione dhe qetësi. Secili prej pjesëmarrësve kontribuoi në mënyrën e vet, duke sjellë qasje unike — nga ata që shfaqën kujdes në përzgjedhjen e ngjyrave dhe detajeve estetike, te ata që sollën humor dhe gjallëri, duke krijuar një ambient të ngrohtë dhe mikpritës për të gjithë.



Veçantia e këtij aktiviteti u pasurua edhe më tej me përgatitjen e një cheesecake-u të përbashkët, i cili u shijua me shumë kënaqësi. Ky gjest i thjeshtë përforcoi edhe një herë idenë se bashkëpunimi dhe ndarja e momenteve të përzemërta janë po aq të rëndësishme sa arritjet tona profesionale. Në Albsig, kujdesi ndaj njëri-tjetrit dhe kultivimi i një kulture të shëndetshme organizative mbeten gjithmonë në zemër të çdo iniciative. Momente të tilla janë dëshmi e frymës së respektit, solidaritetit dhe bashkëpunimit që na karakterizon.

9.2. Një ditë e dedikuar argëtimit, bashkëpunimit dhe frymës së ekipit

Në kuadër të iniciativave për fuqizimin e kulturës organizative dhe ndërtimin e një ambienti pune më të bashkuar, Albsig organizoi një retreat të dedikuar për stafin, që u zhvillua në ambientet e Tropicall Resort, Durrës. Aktiviteti u konceptua si një ditë larg rutinës së përditshme, me fokus te bashkëpunimi, komunikimi ndërpersonal dhe vlerësimi i përbashkët i rrugëtimit të kompanisë.

Gjatë ditës, pjesëmarrësit morën pjesë në një sërë lojërash argëtuese dhe sfidash të ndërtuara sipas formatit team-building, të cilat synonin të forconin lidhjet mes kolegëve dhe të nxisnin një frymë të shëndetshme bashkëpunimi dhe kreativiteti. Nga sfidat individuale deri te aktivitetet në grup, çdo moment ishte një mundësi për të reflektuar mbi rëndësinë e punës në skuadër dhe komunikimit efektiv.



Një nga momentet më të veçanta të ditës ishte organizimi i një quiz-i mbi historikun dhe arritjet e Albsig, që shërbeu si një mënyrë interaktive për të kujtuar pikat kyçe të zhvillimit të kompanisë dhe për të nxitur ndjenjën e përkatësisë. Pyetjet përfshinin fakte historike, të dhëna rreth produkteve dhe nismave më të rëndësishme që kanë ndërtuar profilin e Albsig në tregun e sigurimeve.

Pjesëmarrja entuziaste dhe energjia pozitive e stafit konfirmuan edhe një herë rëndësinë e këtyre aktiviteteve për motivimin dhe angazhimin e brendshëm. Ky retreat nuk është thjesht një ditë argëtimi, por një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi rrugëtimin e përbashkët dhe për të forcuar më tej lidhjet që e bëjnë një ekip të suksesshëm.

Aktivitete të tilla janë tashmë pjesë e kalendarit të përvitshëm të kompanisë dhe përfaqësojnë përkushtimin e Albsig për të ndërtuar një kulturë pune ku bashkëpunimi, mirëqenia dhe motivimi i stafit qëndrojnë në themel të çdo suksesi.



9.3. Nga siguria te investimi: Albsig mirëpret median në ambientet moderne të Downtown One

ALBSIG, pjesë e Grupit Kastrati, mirëpriti përfaqësues të mediave në ambientet e reja në ndërtesën ikonike Downtown One, ku u zhvillua një konferencë për shtyp me drejtues të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest, pasuar nga një tur ekskluziv i hapësirave moderne të kompanive. Ky aktivitet shënoi një moment të rëndësishëm për Albsig, duke reflektuar filozofinë e investimeve afatgjata, inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në tregun shqiptar të sigurimeve dhe financave.

Në fjalën e tij, Plarent Hamzaj, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i ALBSIG, theksoi se qëndrueshmëria dhe besimi janë themelet mbi të cilat Shoqëria ka ndërtuar zhvillimin e saj ndër vite. Ai vuri në dukje se investimi i vazhdueshëm në inovacion, teknologji dhe përmirësimin e përvojës së klientit ka kthyer korrektësinë dhe transparencën në shtylla të pandashme të kulturës së punës së Albsig. Hamzaj shtoi se vizioni i ALBSIG është të mbetet një partner afatgjatë dhe i besueshëm për klientët dhe institucionet financiare, duke kontribuar në forcimin e industrisë së sigurimeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut shqiptar. Sipas tij, vlera e një kompanie nuk matet vetëm me përmasën e saj, por me mënyrën se si ajo qëndron pranë klientëve në momentet vendimtare, një parim që e ka bërë Albsig një emër të respektuar për më shumë se dy dekada.



Në vijim, Dritan Kastrati, Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i ALBSIG, theksoi se rezultatet e kompanisë në trajtim dhe pagesë dëmsh janë dëshmi e qartë e korrektesisë dhe seriozitetit që e karakterizon. Prej më shumë se një dekadë, Albsig renditet ndër liderët e tregut për shlyerjen e dëmeve, me mbi 150 mijë klientë të dëmshpërblyer, ndërsa vetëm në vitin e kaluar 17,157 klientë përfituan dëmshpërblimin e tyre. Ai theksoi se Albsig mban numrin më të ulët të dëmeve pezull, vetëm 4% të totalit të tregut, si dhe numrin më të ulët të proceseve gjyqësore, çka dëshmon efikasitetin dhe transparencën e shoqërisë. Sipas tij, këta tregues janë rezultat i standardeve të larta të përgjegjshmërisë ndaj klientit, që kanë ndërtuar reputacionin e Albsig si një kompani me baza të forta financiare dhe besueshmëri të qëndrueshme në tregun shqiptar dhe rajonal.



Pas konferencës, përfaqësuesit e mediave morën pjesë në një tur të organizuar në ambientet e ALBSIG, ku u njohën nga afër me hapësirat bashkëkohore të punës, sallat e trajnimit dhe qendrat e komunikimit me klientët të Albsig, Albsig Jetë dhe Albsig Invest. Ky investim, që përfaqëson besimin e Grupit Kastrati në potencialin e tregut shqiptar, tregon se standardet europiane janë tashmë një realitet që po ndërtohet çdo ditë në zemër të Tiranës.

9.4. ALBSIG FESTON 21-VJETORIN! 21 vite besim, rritje dhe lidhësi në tregun e sigurimeve

Shoqëria e Sigurimeve ALBSIG kremtoi 21-vjetorin e themelimit me një event festiv të organizuar në ambientet e hollit të Drejtorisë Qendrore në Downtown One, ku morën pjesë drejtues, partnerë dhe punonjës nga të gjitha njësitë e shoqërisë. Ngjarja u karakterizua nga një atmosferë e ngrohtë dhe miqësore, tipike për kulturën e ALBSIG, duke reflektuar harmoninë dhe frymën e bashkëpunimit që e shoqëron shoqërinë prej dy dekadash.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Drejtori i Përgjithshëm vlerësoi kontributin e çdo punonjësi në rrugëtimin e deritanishëm, duke nënvizuar se suksesi i ALBSIG është rezultat i përkushtimit, profesionalizmit dhe besimit të ndërsjellë mes ekipit, klientëve dhe partnerëve. Ai evidentoi arritjet kryesore të Shoqërisë në këto 21 vite, ndër të cilat spikasin pozicionimi si lider në treg në produktet vullnetare të sigurimit, rritja e vazhdueshme e portofolit dhe forcimi i pranisë në tregun vendas.

21
vjet

Gjithashtu, ALBSIG mbetet e pakonkurrueshme në pagesën e dëmeve në kohë rekord, duke e kthyer shërbimin cilësor dhe transparencën në një standard të pandashëm të veprimtarisë së saj. Ky angazhim ndaj klientit ka qenë dhe mbetet një ndër shtyllat kryesore të filozofisë së kompanisë. Gjatë eventit u vlerësuan jo vetëm të arriturat financiare dhe operacionale, por edhe rrugëtimi njerëzor i Shoqërisë. Atmosfera e ngrohtë dhe solidariteti mes punonjësve krijuan një moment reflektimi dhe motivimi për sfidat dhe objektivat e ardhshme.

21 vite ALBSIG përfaqësojnë 21 vite investim në inovacion, profesionalizëm dhe shërbim të dedikuar ndaj klientit, një histori suksesi që vijon të ndërtohet çdo ditë. Shoqëria shikon drejt së ardhmes me besim dhe vendosmëri për të mbetur një ndër aktorët kryesorë të tregut të sigurimeve në Shqipëri.



9.5. Trajnim për Inteligjencën Artificiale: Albsig forcon kapacitetet e stafit drejt inovacionit teknologjik

Në kuadër të përpjekjeve të vazhdueshme për zhvillimin profesional të stafit dhe përmirësimin e proceseve të punës përmes teknologjisë, Shoqëria e Sigurimeve Albsig organizoi një trajnim të dedikuar mbi Inteligjencën Artificiale (AI), mbajtur nga eksperti ndërkombëtar Josh Miekley.

Trajnimi, i zhvilluar me pjesëmarrjen e punonjësve të Drejtorisë Qendrore, pati në fokus mënyrat praktike se si inteligjenca artificiale mund të përdoret për të rritur efikasitetin, automatizuar detyra të përsëritura dhe për të lehtësuar proceset analitike në përditshmërinë e punës.



Gjatë sesionit, z. Miekley ndau një panoramë të gjerë mbi zhvillimet më të fundit në fushën e AI-së, duke ilustruar raste konkrete se si kjo teknologji po transformon industrinë financiare dhe atë të sigurimeve në mbarë botën. Pjesëmarrësit u njohën me mjete praktike që mund të ndihmojnë në krijimin e përmbajtjeve më efikase, analizimin e të dhënave, përmirësimin e komunikimit me klientët dhe mbështetjen e inovacionit të brendshëm. Në vijim të trajnimit, u theksua rëndësia e qasjes etike dhe të përgjegjshme në përdorimin e inteligjencës artificiale, duke respektuar standardet e sigurisë, transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave.

Ky aktivitet shënon një tjetër hap të rëndësishëm në strategjinë e Albsig për të integruar teknologjitë e reja në shërbim të klientit dhe të performancës institucionale, duke nxitur një kulturë inovacioni brenda organizatës. Trajtime të tilla janë pjesë e vizionit tonë për të investuar jo vetëm në teknologji, por edhe në njerëzit tanë. Inteligjenca Artificiale përfaqëson një mundësi të madhe për të rritur produktivitetin, kreativitetin dhe cilësinë e shërbimit që u ofrojmë klientëve. Në përfundim, stafi pjesëmarrës vlerësoi trajnimin si një përvojë frymëzuese dhe praktike, që hap horizonte të reja për përdorimin e AI-së në funksion të zhvillimit profesional dhe organizativ të Albsig.

10 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE VJETORE

Misioni i Shoqërisë ALBSIG JETË SH.A. është shërbimi cilësor në të gjithë klasat e sigurimit të jetës për grupe dhe individë nëpërmjet produkteve cilësore të sigurimit, cilësisë dhe shpejtësisë së pagesës së dëmeve, stabilitetit e ruajtjes të gjendjes financiare. Bazuar në eksperiencën pesë vjecare, si dhe në njohjen nga afër dhe shtrirjen në tregun vendas të shoqërisë bazë Albsig jo jetë dhe aksionerit kryesor të saj, shoqëria Albsig-Jetë sh.a. ka përcaktuar objektivat e saj kryesore

Hartimi i produkteve cilësore të sigurimit, në përshtatje me kërkesat e konsumatorëve dhe me prime reale të përballueshme prej tyre

Krijimi i një rrjeti efektiv të marrjes në sigurim në qytetet kryesore të Shqipërisë në funksion të arritjes së pjesës së tregut të sigurimeve të jetës prej 27 % në vitin e 2025, duke u mbështetur në në vitin 2024 ku shoqëria zuri për periudhën Janar — Tetor 24.68 % të tregut jetë.

Vendosja e një sistemi cilësor të shërbimit në të gjitha drejtimet, me fokus të vecantë në shërbimin e trajtimit dhe pagesës së dëmeve ndaj klienteve ose të tretëve.

Efektiviteti i burimeve njerëzore. Nxitja e politikave bashkëkohore të rekrutimit, motivimit, trainimit dhe programeve sociale.

Cilësia e menaxhimit dhe rritja e rolit të profesionistëve në aspektet e drejtpërdrejta të sigurimit (marrje në sigurim, dëme), në menaxhimin e të gjitha rrisqeve të tjera (vlerësime aktuariale, financiare, të risigurimeve, dëmeve etj).

Rritja e imazhit të shoqërisë dhe shndërrimi i emrit në një sinonim të shërbimit më të mirë në Shqipëri.

Ngritja e nivelit profesional të specialistëve të marrjes në sigurim, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme.

Duke u bazuar edhe në vitin 2024 ku Albsig Jetë Sh.a. pati vitin e pestë të aktivitetit në sigurimin e jetës së debitorit arriti të pozicionohet në vendin e dytë si dhe në vitin 2023, por edhe për vitin 2025 do të ketë veprim intensiv në lidhje me kontratën e sigurimit të jetës së debitorit.

Rritja dhe mbulimi i provigjioneve me burime të mjaftueshme financiare.

Plotësimin e standarteve dhe parametrave të lejuar në lidhje me raportin e shpenzimeve.

Lidhja e marrëveshjeve dhe kontratave efektive të risigurimeve me risigurues seriozë në funksion të rritjes së kapacitetit mbajtës dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të shoqërisë.

Rekrutimin, motivimin dhe rritjen cilësore të burimeve njerëzore të shoqërisë duke sjelle një rritje të konsiderueshme të stafit të shoqërisë për vitin 2025.

Shoqëria Albsig Jetë sh.a. finalizoi hyrjen në ambjentet e reja në fund të vitit 2024, të cilat janë investim i shoqërisë për vitin 2024, duke i dhënë hapësirë për rritje të konsiderueshme stafi dhe ambiente mbështetëse për realizmin e organizimeve të ndryshme si mbledhje, trajnime, takime etj.

Me rritje shumë të ndjeshme është parashikuar kontrata e sigurimit të jetës së debitorit edhe për vitin 2025, duke qenë produkti me peshën specifike më të madhe.



info@albsig-jete.al
www.albsig-jete.al

+355 (0) 4 22 54 664

ALBSIG JETË sh.α.
Bulevardi Bajram Curri,
Albsig HQ, Kati 16, 1010 – Tiranë

